



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Nje ankesë kundër : KOMUNA I KOMUNES SE PRISHTINES

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	616-19-1461-1-2-1
Nr i brendshëm	616 019 045 121

Sa i përket tenderit : FURNIZIMI ME PAJISJE TEKNOLOGJIKE PËR OBJEKTET KOMUNALE DHE BASHKËSITË LOKALE.

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Ilir Kosova shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Fuad Pashe Dibra 23
(Adresa)
Prishtine 10000
(Vendi) (Kodi postar)
038/243-773 038/243-774
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Albert Fazlija
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
albert@ilir-ks.com
(Adresa elektronike)

11.06.2019
(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Kuvendi Komunal Prishtine ka udhëhequr aktiviteti e prokurimit me numër 616-19-1461-121 të shpallur me 22.03.2019 si dhe të dorëzuar me datën 18.04.2019 të ndare në 3 LOT-e. Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë çmimi më i lirë. Me datën 03.06.2019 kemi pranuar njoftimin për operatorin e Pasukesshëm (Letër standarde për tenderuesin e eliminuar), në të cilin janë cekur arsyet në bazë të së cilave jemi eliminuar nga aktiviteti për shkake se:

Loti II Ofertuesi - Ilir Kosova

Tek pozicioni nr. 2 modeli që është ofruar në kolonën C?

- Nuk është printer AIO

Me datën 03.06.2019 njeherit kemi kërkuar të kemi qasje në dokumentacionin e kompanisë së propozuar për dhënie të kontratës –INFINIT. Qasja na është lejuar me datën 05.06.2019.

Me datën 05.06.2019 kemi dërguar kërkesën për rishqyrtim. Me këtë rast kemi bashkangjitur argumentet (brochura-en) për pajisjen të cilën e kemi ofertuar, gjë që tregon se pajisja është AiO.

Me datën 07.06.2019 kemi pranuar VENDIMIN për refuzimin e kërkesës së parashtruar nga kompanija jone dhe vërtetohet vendimi i AK për dhënie të kontratës të publikuar me datën 03.06.2019 dhe të vazhdohet me aktivitetin e prokurimit.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesverbalin e hapjes së tenderit e kemi shkarkuar nga platforma E-Prokurimi

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjedhja preliminare e mosmarreveshjeve

A keni bere kerkese per rishqyrtim prone AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nese po, ofroni detaje mbi kete fakt dhe bashkengjit nje kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarreveshjeve ne perputhje me nenin 108A te LPPse
Prove: te bashkangjitur kerkesen per rishqyrtim

Kompanija jone ka derguar kerkes per rishqyrtim me daten 05.06.2019

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59.2 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 59.4 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

te Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK/Komisioni vlersues gjate vlersimit te ofertave per tenderin ne fjale LOT 2, nuk ka respektuar LPP Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 perkatesisht dispozitat ligjore te lartecekura si dhe nuk ka vepruar ne harmoni me Udhezimin operativ per prokurim publik.

Kompania jone ploteson te gjitha kerkesat dhe kriteret e shfaqura ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit nga autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar me arsyetimin se kompanija jone nuk ka ofertuar AiO

Loti II Ofertuesi - Ilir Kosova

Tek pozicioni nr. 2 modeli qe eshte ofruar ne kolonën C?

- Nuk eshte printer AIO

Ky konstatim i komisionit vleresues eshte i pabaze dhe i qëllimshëm. Qëllimi kryesor i komisionit vlerësues eshte qe te eliminohet kompanija jone dhe kontrata ti jipet kompanise Infinet e cila edhe eshte shpërblyer me kontrate .

Vlerësimi i komisionit se pajisja e ofertuar nga ne Lexmark MB2442DW nuk është AiO është e gabuar pasi që vetë emërtimi i këtij modeli, shkronja e parë M tregon se është multifunksional apo AiO. Ne kemi plotësuar dhe nënshkruar kolonën C si dhe kemi nënshkruar deklaratën nën betim . Ne kolonën C kemi shënuar të gjitha karakteristikat e modelit të ofertuar .

Konstatimi që modeli i broshurës dhe modeli i ofertuar në kolonën C janë të ndryshëm është totalisht i pabazë pasi që broshura përmbanë të gjitha variјantet që mund të konfigurohen për modelin MB2442DW.

Broshura nuk është kërkuar fare në tender dosje, por në për shkak të transparencës dhe për të lehtësuar punë e komisionit vlerësues kemi bahskangjitur broshurën

Prodhuesi ka lënë mundësi që të bëhen disa konfigurime të ndryshme të modelit MB2442 e që me prapashitesa ADWE tregohet konfigurimi i tyre.

Për ne është më rëndësi prapashitesa DW e cila i plotëson të gjitha specifikat e kërkuara.

Për këtë arsye ne nuk e kemi shënuar në kolonën C modelin MB2442ADWE ashtu si qeshtë në broshurën e përgjithshme por kemi shënuar modelin e saktë MB2442DW i cili edhe do të liferohet në rast të dhënies së kontratës.

Komisioni vlerësues gabimisht ka shiqur në internet ku ka hasur në model Lexmark B2442DW i cili është vetëm printer por ky nuk e ka shkronjë M në emërtim dhe ky model nuk është ofertuar nga ne.

Komisioni vlerësues më datën 07.06.2019 ka marrë vendim ku ka refuzuar si të pabazë kërkesën e parashtruar nga ne.

Më këtë vendim njëkohësisht komisioni edhe ka demantuar vlerësimin e parë ku ka cekur se pajisja nuk është AiO , pasi që në këtë vendim të datës 07.06.2019 ka shtuar edhe një konstatim nën pikën 1.2

1.1 Kompanja ka ofruar LEXMARK MB2442DW i cili nuk është printer AIO. ndërsa së bashku me ofertën ka ofruar një katalog me një lloj tjetër të printerit Lexmark MB2442adwe i cili nuk është i njëjt me llojin që është ofruar në kolonën C ku është kërkuar të ceket me saktësi modeli i pajisjeve.

1.2 Është ofruar RADF

DADF apo RADF është karakteristike e pajisjeve AiO.

Sipas komisionit vlerësues kompanija jone nuk ka ofertuar DADF por RADF.

DADF apo RADF është pajisje e njëjte por shkurtesat përdoren ndryshe nga prodhuesi të ndryshëm.

DADF apo Duplexing Automatic Document Feeder përdoret nga Konica Minolta , Canon etj.

RADF apo Reversing Automatic Document Feeder përdoret nga Lexmark , Ricoh etj.

Pajisja ka funksion të njëjte që origjinalin ta skenojë në të dy anët ashtu siq është kërkuar në specifika teknike .

Çka është edhe më interesante dhe që e konfirmon pohimin tonë se AK dhe komisioni vlerësues kanë pasur qellim të eliminimit të kompanisë sonë , kompanija fituese ka ofertuar pajisje në LOT 2. Brother DCP L-6600DW i cili nëse e shiqoni broshurën nuk ka DADF e as RADF por vetëm ADF (automatic document feeder).

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AK/komisoni vlersues ka ardhc deri te eliminimi i padrejte i kompanise sone nga procedura e tenderit dhe ne kete menyre nuk eshte respektuar kerkesa decideve e LPP perkatesisht Neni 60 qe kontrata ti ipet tenderuesit te pergjegjshem me cmimin me te ulet, ne kete menyre ne na eshte mohuar e drejta e fitimit te nje kontrate publike dhe fitimi simbolik i paramenduar nga kjo kontrate.

Poashtu rrjedhimisht dhenia e kontrates per OE me te shtrejte se oferta jone, i renditur per kete aktivitet te prokurimit demton buxhetin e shtetit perkatesisht KK Prishtine edhe ne kete pike AK bie ndesh me neni 6.1 te LPP i cili obligon AK ti shfrytetoje fondet ne menyre sa me cfikase dhe ekonomike.

Kerkojme nga organi shqyrtues i prokurimit qe te aprovoj ankesen tone si te bazuar lenda te kthehet ne ri-vleresim dhe kontrata ti ipet kompanise sone si tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet

Kerkojme qe ankesa te aprovohet si e bazuar.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *Dosja e tenderit*
- b) *Procesverbali i hapjes*
- c) *Letra standarde per tenderuesin e pasuksesshem e datës 03.06.2019*
- d) *Kërkesën për Rishqyrtim të vendimit 05.06.2019*
- e) *Vendimin e AK per refuzim te datës 07.06.2019*
- f) *Broshura e Lexmark MB2442DW*
- g) *Broshura e Brother DCP-L6600DW (pajisja e fituesit)*
- h) *Deshmine e pagese sipas nenit 118 te LPP*
- i)